

REZOLUTË

- Të bashkuar kundër lajmit të rremë -

Pas pjesëmarrjes në Konferencën Ndërkombëtare "Agjencitë e Lajmeve kundër Lajmit të Rremë" të organizuar nga Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATA) më 3-4 dhjetor 2018 në Tiranë, ne kemi rënë dakord të bashkëpunojmë sipas udhëzimeve të mëposhtme, të përshkruara më hollësisht në një deklaratë bashkëlidhur Rezolutës:

Ne ndajmë pikëpamje të ngjashme në lidhje me mënyrën se si duhet të veprojmë në unitet dhe, ndërsa njohim larminë tonë, kemi rënë dakord, në veçanti, për:

- Bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet agjencive të lajmeve për verifikimin e lajmeve dhe identifikimin e shpejtë të lajmeve të rreme.
- Ndërtimin e instrumenteve dhe hartimin e rregullave efektive për të fuqizuar përdoruesit e internetit dhe gazetarët në lidhje me trajtimin e dezinformimit.
- Promovimin e mediave të besueshme dhe edukimin e përdoruesve se si të lundrojnë në mjedisin dixhital.
- Përmirësimin e transparencës së lajmeve online përmes përfshirjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të gazetarisë profesionale.
- Mbrojtjen e diversitetit dhe qëndrueshmërisë së ekosistemit të medieve që prodhojnë lajme reale.

Ne i bëjmë thirrje të gjitha agjencive të lajmeve, pa marrë parasysh nëse ato janë të financuara nga shteti ose subjekte private, si dhe shoqatave ndërkombëtare të agjencive të lajmeve, të bashkohen me ne për të respektuar Rezolutën.

Nismëtarët:

- ATA-Shqipëri,
- ANA MPA-Greqi,
- HINA-Kroaci,
- BTA-Bullgari,
- AZERTAC- Azerbajxhan,
- PAP - Poloni,
- Kosovapress-Kosovë,
- AGERPRES-Rumani,
- TASR-Sllovaki,
- UKRINFORM -Ukrainë,
- CNA-Qipro,
- MIA-Maqedonia e Veriut,
- FENA-Bosnje-Hercegovinë,
- TANJUG-Serbi ,
- AA-Turqi.